



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 194**

**12 dhjetor**

**2013**

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 170/2013  
datë 14.11.2013

Për miratimin e marrëveshjes së asistencës së shërbimit doganor

Faqe

8009

**LIGJ**  
**Nr. 170/2013**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ASISTENCËS SË SHËRBIMIT DOGANOR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është miratimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Crown Agents Limited”.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ofrimi i shërbimit të asistencës ndaj administratës doganore, sipas standardeve të Bashkimit Europian dhe sipas praktikave më të mira të rajonit, për përmirësimin e performancës, rritjen e të ardhurave dhe luftën ndaj korrupsionit në administratën doganore të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Subjektet**

Subjekte të këtij ligji janë:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i cili vepron në cilësinë e autoritetit kontraktues;

b) shoqëria “Crown Agents Limited”, shoqëri tregtare e organizuar dhe që funksionon në përputhje me ligjet e Mbretërisë së Bashkuar, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Mbretërisë së Bashkuar, me nr. 3259922, që do të ofrojë shërbimin e asistencës së përshkruar në nenin 2 të këtij ligji.

**Neni 4**  
**Përkufizime**

1. Në këtë ligj dhe në marrëveshjen bashkëlidhur, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Autoritet kontraktues” është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;
- b) “Autoritet nënshkrues” është Ministria e Financave, në cilësinë e nënshkruesit të marrëveshjes në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave;
- c) “Kontraktues” është shoqëria “Crown Agents Limited” ose filiali i saj i themeluar, me qëllim zbatimin e marrëveshjes dhe në përputhje me zëvendësimin e përgjegjësive, sipas marrëveshjes me autoritetin kontraktues.

2. Përkufizimet e termave të marrëveshjes përcaktohen në tekstin e marrëveshjes.



## Neni 5

### **Të drejtat dhe detyrimet e autoritetit nënshkrues**

Autoriteti nënshkrues ngarkohet:

- a) të nënshkruajë marrëveshjen në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave;
- b) të nënshkruajë bashkë me përfaqësuesin e kontraktuesit dhe të caktojë:
  - i) përfaqësuesin/përfaqësuesit e autorizuar si persona kontakti;
  - ii) grafikun e realizimit të detyrimeve nga ana e kontraktuesit;
- c) të ndjekë zbatimin e marrëveshjes;
- ç) të asistojë kontraktuesin, në funksion të realizimit të qëllimit dhe të objektit të këtij ligji dhe marrëveshjes bashkëlidhur;
- d) të negociojë dhe të nënshkruajë dokumentacionin e parashikuar, sipas marrëveshjes bashkëlidhur (nëse ka);
- dh) të miratojë listën e ekspertëve të punësuar nga kontraktuesi;
- e) të bëjë pagesat, në përputhje me kushtet e marrëveshjes dhe sipas një kalendarit të miratuar nga autoriteti nënshkrues dhe kontraktuesi.

## Neni 6

### **Të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit**

1. Kontraktuesi ndjek dhe zbaton me përpikëri angazhimet e marra në marrëveshjen bashkëlidhur, brenda afateve të parashikuara dhe në përputhje me kalendarin e miratuar bashkërisht me autoritetin nënshkrues.

2. Personeli i kontraktuesit:

- a) pajiset me leje për hyrjen dhe shoqërimin e personelit shqiptar, të angazhuar në funksione të lidhura me mbledhjen e të ardhurave doganore;
- b) asiston personelin doganor në analizën e informacioneve të lidhura me shërbimin doganor;
- c) asiston personelin e administratës doganore, që kryen funksione hetimi, kontrolli e verifikimi, dhe i raporton sa më parë autoritetit nënshkrues për rastet e abuzimit, të korrupsionit e të fenomeneve të ngjashme me to, duke përfshirë raste që prekin drejtpërdrejt apo tërthorazi personelin doganor;
- ç) në funksion të ofrimit të shërbimit, të mund të përdorë logon e tij, si dhe sistemet zanore shtesë të alarmit dhe atë të sinjalizimit pamor, me dritë vezulluese, në automjetet e tij.

3. Shoqëria “Crown Agents Limited” mbetet përgjegjëse për të gjitha detyrimet e rrjedhura nga marrëveshja, bashkëlidhur këtij ligji, edhe pas krijimit të filialit shqiptar të shoqërisë “Crown Agents Limited”.

## Neni 7

### **Përfshirja nga tatimet dhe taksat**

1. Kontraktuesi, në funksion të zbatimit të marrëveshjes, bashkëlidhur këtij ligji, dhe furnizimit të shërbimeve apo mallrave, sipas marrëveshjes, përfshirëtohet nga:

- a) tatimfitimi;
- b) tatimi mbi dividentin;
- c) tatimi mbi vlerën e shtuar në import dhe tarifatat doganore;
- ç) taksat dhe tarifatat në nivel vendor.

2. Personeli i tij i huaj, i kontraktuar nga kontraktuesi për kryerjen e shërbimeve, në funksion të zbatimit të marrëveshjes, bashkëlidhur këtij ligji, përfshirëtohet nga:

- a) tatimi mbi të ardhurat personale;
- b) sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- c) TVSH-ja dhe tarifatat doganore, në lidhje me importet për sendet e tij vetjake.

#### Neni 8

##### **Përjashtimi i furnizimeve**

Furnizimi i shërbimeve të kontraktuesit është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja.

#### Neni 9

##### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një afat 24-mujor (viti I dhe viti II), me të drejtë rinovimi edhe 12 muaj të tjerë (viti III), sipas përcaktimeve të nenit 2.3 të kontratës. Vendimi për rinovimin ose përfundimin e zbatimit të marrëveshjes merret nga Këshilli i Ministrave.

2. Autoriteti kontraktues ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes brenda dymbëdhjetë muajve të parë të zbatimit të saj, nëse nuk përmbushen treguesit kryesorë të performancës, sipas parashikimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 10

##### **Nënshkrimi i marrëveshjes dhe hyrja në fuqi**

1. Marrëveshja, bashkëlidhur këtij ligji, nënshkruhet dhe hyn në fuqi sipas parashikimit të pikës 2.1 të saj.

2. Në rast të një kërkesë për ndryshimin e termave e të kushteve të marrëveshjes, autoriteti kontraktues autorizohet të miratojë ndryshimin, me kusht që vlera e përgjithshme e shërbimit, e përcaktuar në marrëveshje, të mos rritet.

#### Neni 11

##### **Pagesa për ofrimin e shërbimit**

1. Pagesa për ofrimin e shërbimit, objekt i këtij ligji, përballohet nga buxheti i parashikuar për Ministrinë e Financave.

2. Pjesa e pagesës për periudhën e mbetur gjatë vitit 2013 përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Totali i pagesës, kushtet dhe mënyra e pagesës janë si ato të parashikuara në marrëveshjen bashkëlidhur këtij ligji.

#### Neni 12

##### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për:
  - a) shërbimet dhe pajisjet që do të vihen në dispozicion nga kontraktuesi;
  - b) detyrimin e autoritetit kontraktues për pajisjen me mjedise për zyra, si dhe për pajisje teknike e infrastrukturë tjetër që i nevojitet kontraktuesit;
  - c) planin e pagesave dhe të mbajtjeve nga pagesat;
  - ç) formatin dhe rregullat e rishikimeve tremujore të treguesve kryesorë të performancës;
  - d) përshkrimin e punës së kontraktuesit;
  - dh) modelin e letrës së konfirmuar e të transferueshme të gatshme të kredisë në favor të kontraktuesit;



- e) modelin e garancisë së paradhënies në favor të autoritetit kontraktues;
- ë) ndryshimin për rastet e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji;
- f) modelin e garancisë së shoqërisë mëmë;
- g) njoftimin për zgjatjen e afatit të kontratës për vitin e tretë;
- gj) modelin e letrës së konfirmuar e të transferueshme të gatshme të kredisë në favor të kontraktuesit për automjetet.

2. Ngarkohet Ministri i Financave që, në zbatim të këtij ligji, të miratojë urdhrat për:

- a) emërimin e anëtarëve të Këshillit të Menaxhimit të Programit, si përfaqësues të autoritetit kontraktues;
- b) grafikun e pagesave;
- c) klasifikimin e dokumentacionit që duhet nënshkruar, në bashkëpunim me kontraktuesit, si dhe funksionarin e autorizuar për nënshkrimin;
- ç) përfundimin e efekteve të marrëveshjes me kontraktuesin, në rastet e parashikuara nga marrëveshja.

3. Pas miratimit, aktet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni bëhen pjesë përbërëse e marrëveshjes.

Neni 13

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratur në datën 14.11.2013

**Datë [    ], nëntor, 2013**

### **MARRËVESHJE**

**PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË REFORMËS NË DOGANAT SHQIPTARE  
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI  
I MINISTRAVE, DHE CROWN AGENTS LIMITED, MBRETËRIA E BASHKUAR**

Numër reference i marrëveshjes [    ]

Kjo marrëveshje (referuar më poshtë si “kontrata”) lidhet sot në datën \_\_\_\_ të muajit nëntor 2013, midis, nga njëra anë qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, përfaqësuar ky i fundit nga Ministria e Financave (referuar më poshtë si “Autoriteti Kontraktues”) dhe, nga ana tjetër, Crown Agents Limited nga Mbretëria e Bashkuar, themeluar rregullisht sipas legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar, me numër regjistrimi të shoqërisë 3259922, përfaqësuar rregullisht nga (\_\_\_\_) (referuar më poshtë si “Kontraktuesi”).

Ndërsa:

a) Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Kontraktuesit që të ofrojë shërbime asistence për Autoritetin Kontraktues në lidhje me reformën e administratës doganore të Shqipërisë, me qëllim përmirësimin e performancës, rritjen e të ardhurave dhe zvogëlimin e korrupsionit, sipas kushteve të kësaj kontrate (më poshtë referuar si “shërbimet”); dhe

b) Kontraktuesi i ka deklaruar Autoritetit Kontraktues se ka aftësitë e duhura profesionale, burimet teknike dhe njerëzore;

Atëherë palët e kësaj kontrate bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. Dokumentet e mëposhtme miratohen me vendim të Autoritetit Kontraktues, në marrëveshje me shkrim me Kontraktuesin dhe do të konsiderohen se janë pjesë përbërëse e marrëveshjes.

Shtojca A - Shërbimet dhe pajisjet që do të sigurohen nga Kontraktuesi

Shtojca B - Zyrat, pajisjet teknike dhe lehtësira të tjera që do të sigurohen nga Autoriteti Kontraktues

Shtojca C - Pagesa dhe mbajtje nga pagesa

Shtojca D - Modeli i letrës së konfirmuar e të transferueshme të gatshme të kredisë në favor të Kontraktuesit

Shtojca E - Përshkrimi i punës së Kontraktuesit

Shtojca F - Modeli i garancisë së paradhënies për Autoritetin Kontraktues

Shtojca H - Lista e personelit të huaj që do të punësohen sipas kontratës

Shtojca I - Modeli i treguesve kryesorë të performancës të pranuar (TKP-të e pranuar)

Shtojca J - Modeli i garancisë së shoqërisë mëmë

Shtojca K - Modeli i njoftimit për zgjatjen e afatit të kontratës (viti i 3-të)

Shtojca L - Modeli i letrës së konfirmuar e të transferueshme të gatshme të kredisë në favor të Kontraktuesit (automjetet)

2. Të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve janë përcaktuar në këtë kontratë dhe, në veçanti:

a) Kontraktuesi do t'i kryejë shërbimet në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate; dhe

b) Autoriteti Kontraktues do t'i kryejë pagesat ndaj Kontraktuesit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

Kushtet e kontratës

## 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### 1.1 Përkufizime

Me përjashtim të rastit kur konteksti i kontratës kërkon një shpjegim tjetër, termat e mëposhtëm, kudo që do të përdoren në këtë kontratë, do të kenë kuptimin si më poshtë:

a) “Treguesit kryesorë të performancës të pranuar” (ose “TKP-të e pranuar”) nënkuptojnë treguesit kryesorë të performancës, të listuar në pjesën I, pjesën II, pjesën III dhe pjesën IV të modelit bashkëngjitur në shtojcën I, të pranuar nga palët në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 3 të seksionit 2 të shtojcës C të kontratës;

b) “Shqipëria” nënkupton Republikën e Shqipërisë;

c) “Ditë pune” nënkupton çdo ditë, e cila nuk është ditë e shtunë, e diel ose ditë pushimi zyrtar në Shqipëri, në të cilën bankat janë të hapura për punë;

d) “Procedura e kontrollit të ndryshimeve” nënkupton procedurën për miratimin e ndryshimeve të shërbimeve ose kontratës, të parashikuar në nenin 9 të kontratës;

e) “Kontratë” nënkupton kontratën e nënshkruar nga palët, pjesë përbërëse e së cilës janë shtojcat e saj;

f) “Faza e mobilizimit të kontratës” nënkupton periudhën 2-mujore që pason datën e fillimit të shërbimeve;

g) “Kontraktues” nënkupton Crown Agents Limited ose filialin shqiptar të Crown Agents në rastin e nënshkrimit të kontratës së zëvendësimit në përputhje me pikën 8.5;

h) “Filiali shqiptar i Crown Agents” nënkupton një shoqëri filial, të cilën Kontraktuesi mund ta regjistrojë në Shqipëri;

i) “Ditë(t)” nënkupton ditë(t) kalendarike;

j) “Datë efektive” nënkupton datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate sipas nenit 2.1 të saj;

k) “Familjarët” nënkupton në lidhje me personelin: i) bashkëshortin, partnerin civil ose partnerin; dhe ii) djalin, thjeshtrin, vajzën, thjeshtrën, nëse janë nën 18 vjeç ose 21 vjeç dhe në



edukim të vazhdueshëm, dhe “partner” nënkupton një person që bashkëjeton me personelin, njësoj sikur të jetë i martuar ose në një bashkëjetesë civile;

l) “Përfitim i padrejtë” nënkupton një pagesë ose dhuratë (zakonisht, por jo detyrimisht, për një punonjës që kryen funksion publik), me qëllim që marrësi i saj të kryejë një detyrë ose funksion ose të përshpejtojë kryerjen e detyrës ose funksionit, e cila ndryshon nga një pagesë e ligjshme e caktuar në mënyrë zyrtare dhe një tarifë e përcaktuar për kryerjen e detyrës apo funksionit;

m) “Monedhë e huaj” nënkupton çdo monedhë të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë;

n) “Personel i huaj” nënkupton shtetasit e huaj, të cilët, në momentin e lidhjes së kontratës së punësimit apo të konsulencës nga kontraktuesi, e kanë vendbanimin jashtë Shqipërisë;

o) “Personel lokal” nënkupton shtetas shqiptarë, të cilët në kohën e punësimit nga Kontraktuesi, e kanë vendbanimin e tyre në Shqipëri;

p) “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues dhe Kontraktuesin, sipas rastit, dhe “palët” nënkupton si Autoritetin Kontraktues ashtu edhe Kontraktuesin;

q) “Personel” nënkupton personat e kontraktuar në çdo kohë nga Kontraktuesi si punëmarrës ose këshilltarë të tij dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të çdo funksioni tjetër sipas kësaj kontrate;

r) “Këshilli i menaxhimit të programit” (ose “KMP”) nënkupton këshillin e caktuar në përputhje me nenin 5.1.2 (d), i cili do të drejtohet nga një përfaqësues i autorizuar i Autoritetit Kontraktues (kryetari i KMP-së) dhe do të përbëhet nga përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe përfaqësues të Kontraktuesit, të cilët do të mbikëqyrin përmbushjen e kontratës;

s) “Zbritje nga pagesa” nënkupton: i) zbritjet nga të ardhurat mujore të synuara; ii) zbritjet e performancës mujore; iii) zbritjet nga pragu mujor, të përcaktuara në shtojcën C, të cilat do të zbriten e mbahen nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të seksionit 2 të shtojcës C;

t) “Shërbime” nënkupton punën që do të kryhet nga Kontraktuesi, të rënë dakord në këtë kontratë, sipas përshkrimit në shtojcën A dhe shtojcën E bashkëngjitur;

u) “Data e fillimit të shërbimeve” nënkupton datën në të cilën Kontraktuesi ka detyrimin për të filluar shërbimet sipas nenit 2.2 të kësaj kontrate;

v) “Taksë” nënkupton tatimin mbi fitimin, tatim dividendi, tatim mbi të ardhurat, TVSH-në, taksat doganore dhe akcizë, kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, taksat bashkiake dhe vendore dhe çdo taksë tjetër, tarifë, detyrim, pagesë të detyruar, të drejtpërdrejtë ose jo;

w) “Palë e tretë” nënkupton çdo person ose entitet tjetër, përveç Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit;

x) “TVSH” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi xhiron, shitjen ose çdo tatim tjetër korrespondues indirekt, të zbatueshëm në Shqipëri.

## 1.2 Marrëdhënia midis palëve

Kontraktuesi, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, ka kontroll të plotë mbi personelin që kryen shërbimet, dhe mban përgjegjësi të plotë për shërbimet e kryera nga personeli për llogari të tij.

## 1.3 Ligji që rregullon kontratën

1.3.1 Ligjet shqiptare: Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Kontraktuesin me shkrim për të gjithë kuadrin ligjor që ka lidhje me shërbimet, dhe Kontraktuesi, pasi të marrë këtë njoftim, do të zbatojë këtë kuadrë ligjor dhe do të marrë masat që edhe personeli i tij të zbatojë kuadrin ligjor shqiptar.

1.3.2 Duke iu referuar nenit 1.3.1 më sipër, kjo kontratë, kuptimi dhe interpretimi i saj, dhe marrëdhënia midis palëve, do të rregullohen nga ligji anglez, për sa kohë ky ligj nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

#### 1.4 Gjuha

Kjo kontratë do të nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjeje apo konflikti midis versionit të kontratës në gjuhën angleze dhe versionit të kontratës në gjuhën shqipe, versioni i kontratës në gjuhën angleze ka përparësi.

#### 1.5 Titujt

Titujt e neneve të kësaj kontrate nuk do të kufizojnë, ndryshojnë apo prekin përmbajtjen e neneve.

#### 1.6 Njoftimet

1.6.1 Çdo njoftim, kërkesë ose miratim që kërkohet ose lejohet të bëhet sipas kësaj kontrate, duhet të jetë me shkrim, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Çdo njoftim, kërkesë ose miratim i tillë do të gjykohet se është bërë ose kryer në momentin e dorëzimit dorazi të përfaqësuesi i autorizuar i palës së cilës i drejtohet njoftimi, ose në rast se dërgohet me postë me lajmërimarrje, *e-mail* ose faks te pala tjetër. Adresat e kontaktit do të jenë ato të vendosura nga palët në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes.

1.6.2 Njoftimi do të konsiderohet se është kryer:

- a) Në rastin e dërgesës dorazi, ose me postë, me lajmërimarrje në momentin e dërgesës;
- b) Në rastin e faksimiles - në kohën e marrjes së raportit të duhur të transmetimit nga ana e pajisjes dërguese të faksit, nëse transmetimi ndodh brenda orëve normale të punës të marrësit të njoftimit; në të kundërt, në orën lokale 09:30 të ditës së nesërme të punës për marrësin e njoftimit;
- c) Në rastin e *e-mail*-it, barra e provës për marrjen e *e-mail*-it është në ngarkim të dërguesit, i cili merr konfirmimin me shkrim (nëpërmjet “konfirmimit të marrjes” ose *e-mail*-it ose çdo mënyrë tjetër) të marrësit, se marrësi e ka marrë *e-mail*-in përkatës. Çdo kopje e njoftimit të dërguar me *e-mail*, do të konsiderohet se është marrë në mënyrë të rregullt në ditën e punës të dërgimit të konfirmimit në lidhje me *e-mail*-in përkatës ose çdo konfirmimi tjetër me shkrim nga marrësi i *e-mail*-it.

#### 1.7 Vendi i përmbushjes së kontratës

Kontrata do të përmbushet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shërbimet do të ofrohen në vendndodhjet e përcaktuara në shtojcën E bashkëngjitur dhe, atëherë kur vendndodhja e një detyre specifike nuk është përcaktuar në kontratë, ajo do të përcaktohet me dakordësinë e përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit.

#### 1.8 Përfaqësuesit e autorizuar

1.8.1 Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar sipas kësaj kontrate dhe çdo dokument, i cili kërkohet apo lejohet të nënshkruhet sipas kësaj kontrate, nga Autoriteti Kontraktues apo Kontraktuesi, mund të kryhet apo nënshkruhet nga personat e mëposhtëm:

Për Autoritetin Kontraktues:

[Ministri i Financave]

ose

[Zëvendësministri i Financave] (i cili do të jetë kryetari i KMP-së)

ose

[Drejtori i Përgjithshëm i Doganave]

ose zëvendësuesit e tyre të njoftuar me shkrim Kontraktuesit kohë pas kohe nga Autoriteti Kontraktues

Për Kontraktuesin:

\_\_\_\_\_ Drejtori i Operacioneve

ose

\_\_\_\_\_ Drejtori i Biznesit për Dogana dhe Lehtësimi i Tregtisë

ose

\_\_\_\_\_ Drejtori i Programit





ose zëvendësuesit e tyre të njoftuar me shkrim Autoritetit Kontraktues kohë pas kohe nga Kontraktuesi

#### 1.9 Taksat

1.9.1 Kontraktuesi, në funksion të zbatimit të marrëveshjes, si dhe furnizimit të shërbimeve apo mallrave sipas marrëveshjes, do të përjashtohet nga çdo tatim, taksë apo detyrime të tjera të ngjashme, të vendosura nga legjislacioni në fuqi, sipas përcaktimeve të bëra në marrëveshje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Tatimfitimin;
- Tatimin mbi dividendin;
- TVSH-në në import dhe tarifat doganore;
- Taksat dhe tarifat në nivel vendor.

Personeli i tij i huaj, i kontraktuar nga Kontraktuesi, për kryerjen e shërbimeve në funksion të zbatimit të marrëveshjes, përjashtohet nga:

- Tatimi mbi të ardhurat personale;
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- TVSH-ja dhe tarifat doganore në lidhje me importet për sendet e tij vetjake.

#### 1.9.2 Furnizimi i shërbimeve nga Kontraktuesi është i përjashtuar nga TVSH-ja.

1.9.3 Autoriteti Kontraktues do t'i kryejë të gjitha pagesat sipas kësaj kontrate, pa bërë asnjë mbajtje apo zbritje në burim në lidhje me ndonjë taksë. Nëse mbajtja apo zbritja në burim është një kërkesë ligjore, Autoriteti Kontraktues, kur të kryejë pagesën për të cilën kërkohet mbajtja ose zbritja në burim, do t'i paguajë Kontraktuesit dhe një shumë shtesë, së bashku me pagesat përkatëse, në mënyrë të tillë që Kontraktuesi të marrë të njëjtën shumë që do të merrte sikur zbritja apo mbajtja në burim të mos ishte kryer.

#### 1.10 Garancitë

1.10.1 Autoriteti Kontraktues i deklaron dhe garanton Kontraktuesit se: i) personi që do të nënshkruajë këtë kontratë në emër të Autoritetit Kontraktues, është i autorizuar rregullisht për të nënshkruar këtë kontratë; ii) Autoriteti Kontraktues ka të gjithë autoritetin dhe miratimet e nevojshme për të lidhur këtë kontratë dhe për të përmbushur detyrimet e tij të parashikuara në të; iii) kjo kontratë është autorizuar dhe lidhur në përputhje me ligjin shqiptar.

#### 1.11 Veçimi

1.11.1 Nëse ndonjë nen ose pjesë e tij në këtë kontratë është ose bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, ai do të ndryshohet për aq sa është e nevojshme për ta bërë atë ose pjesë të tij, të ligjshëm, të vlefshëm ose të zbatueshëm. Nëse ky ndryshim nuk është i mundur, neni apo pjesa përkatëse e tij do të konsiderohet si i fshirë. Çdo ndryshim apo fshirje e një neni apo pjesë të tij sipas këtij parashikimi, nuk do të prekë vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e pjesës tjetër të kontratës.

1.11.2 Nëse ndonjë nen apo pjesë e tij në këtë kontratë është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, palët do të negociojnë në mirëbesim ndryshimin e atij neni, në mënyrë të tillë që neni i ndryshuar të jetë i ligjshëm, i zbatueshëm dhe i vlefshëm dhe me aq sa të jetë e mundur, të arrijë rezultatin e synuar tregtar të neni fillestar.

### 2. Fillimi, përfundimi, ndryshimi dhe zgjidhja e Kontratës

#### 2.1 Hyrja në fuqi e kontratës

2.1.1 Kjo kontratë do të hyjë në fuqi të plotë në datën në të cilën do të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme (data efektive):

a) Parlamenti shqiptar ka miratuar një ligj, i cili miraton lidhjen e kontratës nga Autoriteti Kontraktues dhe ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë;

b) Bordi i drejtorëve të Kontraktuesit ka marrë një vendim që miraton dhe ratifikon ekzekutimin e kontratës nga Kontraktuesi dhe Kontraktuesi i ka dërguar Autoritetit Kontraktues një kopje të këtij vendimi të njëzuar nga sekretari i kompanisë së Kontraktuesit;

c) Kontraktuesi i ka paraqitur Autoritetit Kontraktues një garanci në lidhje me paradhënien e pagesës në përputhje me nenin 6.1.2, thelbësisht sipas modelit të përcaktuar në shtojcën F;

d) Kontraktuesi ka marrë paradhënien e pagesës së përcaktuar në nenin 6.1.2; dhe

e) Kontraktuesi ka marrë një letër të konfirmuar të transferueshme dhe të gatshme kredie të lëshuar në favor të tij, thelbësisht në përputhje me modelin e paraqitur në shtojcën D (dhe në formë përfundimtare të pranueshme për Kontraktuesin, pranimi përfundimtar i së cilës do t'i konfirmohet me shkrim Autoritetit Kontraktues nga Kontraktuesi), të lëshuar nga [Banka] Shqipëri dhe konfirmuar rregullisht nga [Banka] Londër.

2.1.2 Kontraktuesi do të bëjë përpjekjet e tij më të mira që të sigurojë se garancia e paradhënies së pagesës sipas nenit 2.1.1 (c) do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktues brenda 7 ditëve, ose nga data e botimit të ligjit të Parlamentit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë sipas nenit 2.1.1 (a), ose nga data e dërgimit nga Kontraktuesi të vendimit të bordit të drejtorëve të referuar në nenin 2.1.1 (b), cilado datë të jetë më e vonë. Autoriteti Kontraktues do të bëjë përpjekjet e tij më të mira që të sigurohet se paradhënia e pagesës, e parashikuar në nenin 2.1.1 (d), do t'i paguhet Kontraktuesit brenda 14 ditëve, ose nga data e botimit të ligjit të Parlamentit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë sipas nenit 2.1.1 (a), ose nga data e dërgimit nga Kontraktuesi të vendimit të bordit të drejtorëve të referuar në nenin 2.1.1 (b), cilado datë të jetë më e vonë. Në çdo rast, nëse kontrata nuk hyn në fuqi brenda 2 (dy) muajve nga data e nënshkrimit të saj, Kontraktuesi ka të drejtë që, me anë të një njoftimi me shkrim në adresë të Autoritetit Kontraktues të deklarojë pavlefshmërinë e kontratës.

#### 2.2 Data e fillimit të shërbimeve

Në përputhje me nenin 2.1.1, Kontraktuesi do t'i fillojë shërbimet në datën efektive (data e fillimit të shërbimeve).

#### 2.3 Mbarimi i kontratës

2.3.1 Me përjashtim të zgjidhjes së kontratës sipas nenit 2.7, apo zgjatjes së afatit të saj nga Autoriteti Kontraktues sipas parashikimeve të nenit 2.3.2 ose 2.3.3, kjo kontratë do të përfundojë në fund të afatit 24-mujor nga data e fillimit të shërbimeve (afati).

2.3.2 i) Autoriteti Kontraktues, jo më vonë se 10 ditë pas përfundimit të afatit 21-mujor nga data e fillimit të shërbimeve, nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Kontraktuesit sipas nenit 1.6 (njoftimet) dhe në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcën K, mund të zgjasë afatin e kontratës për një periudhë tjetër 1-vjeçare (njëvjeçare), sipas kushteve të nenit 2.3.2 (ii) ("Njoftimi për zgjatjen e afatit të kontratës (viti i 3-të)").

ii) Zgjatja e kontratës për vitin e 3-të do të kushtëzohet me marrjen nga ana e Kontraktuesit, brenda 10 ditëve nga njoftimi për zgjatjen e kontratës (viti i 3-të), të zgjatjes së afatit të letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (për shërbimet), të përmendur në nenin 2.1.1 (e) deri në fund të vitit 3 + 6 muaj (sipas një forme të pranueshme nga Kontraktuesi, pranim ky, i cili do t'i konfirmohet me shkrim Autoritetit Kontraktues nga Kontraktuesi), të lëshuar nga [Banka], Shqipëri dhe konfirmuar rregullisht nga [Banka], Londër.

2.3.3 Përveç së drejtës së Autoritetit Kontraktues sipas nenit 2.3.2 më sipër, palët me marrëveshje të veçantë të nënshkruar me shkrim nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës prej tyre, mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate.

#### 2.4 Tërësia e kontratës

2.4.1 Kjo kontratë përbën të gjithë marrëveshjen midis palëve në lidhje me objektin e saj dhe merr përparësi, si dhe përfundon të gjitha marrëveshjet, premtimet, garancitë, sigurimet, deklaratimet dhe kuptimet e mëparshme të palëve midis tyre, qoftë ato me shkrim apo me gojë në lidhje me këtë objekt.

2.4.2 Secila palë pranon se nuk ka asnjë të drejtë për dëmshpërblim në lidhje me deklaratime, përfaqësime, siguri ose garanci (qofshin ato të bëra rastësisht apo në mënyrë të pakujdesshme), përveç atyre që janë parashikuar shprehimisht në këtë kontratë.



## 2.5 Ndryshimi

Asnjë ndryshim i kësaj kontrate nuk hyn në fuqi, nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët (ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar) në përputhje me procedurën e kontrollit të ndryshimit të përcaktuar në nenin 9. Secila palë do të gjykojë me kujdes çdo propozim për ndryshim të bërë nga pala tjetër.

## 2.6 Forca Madhore

### 2.6.1 Përkufizim

a) Për qëllim të kësaj kontrate, “Forcë Madhore” nënkupton një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton që përmbushja e detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin, por jo vetëm, luftën, protestat, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthime, stuhi, përmytje ose kushte të tjera moti të vështira, greva, pezullime ose aksione të tjera industriale (me përjashtim të rastit kur mosbindja civile, greva, pezullimi apo aksionet e tjera industriale janë në kontrollin e palës, e cila duhet të parandalojë Forcën Madhore) ose konfiskimin;

b) Forca Madhore nuk përfshin një ngjarje, e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njëres palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj; as një ngjarje të cilën, një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme, duhet ta kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë;

c) Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

### 2.6.2 Mosshkelja e kontratës

Dështimi i njëres palë për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj në këtë kontratë, nuk do të gjykohet si shkelje ose mospërmbushje e kësaj kontrate, për sa kohë pamundësia për të përmbushur ndodh për shkak të një ngjarjeje të Forcës Madhore, me kusht që pala e prekur nga kjo ngjarje të ketë kryer të gjitha parandalimet e arsyeshme, treguar kujdesin e duhur dhe marrë të gjitha masat alternative, të gjitha me synimin për të përmbushur kushtet dhe detyrimet e kësaj kontrate.

### 2.6.3 Masat që duhen marrë:

a) Një palë e prekur nga një ngjarje e Forcës Madhore, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar pamundësinë e kësaj pale për të përmbushur detyrimet e saj në këtë kontratë me minimumin e vonesës;

b) Pala e prekur nga një rast i Forcës Madhore, do të njoftojë palën tjetër me shkrim (nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar të Kontraktuesit, ndërsa në rastin e Autoritetit Kontraktues, nëpërmjet kryetarit të KMP-së) në lidhje me këtë rast, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se katërbëdhjetë (14) ditë pas ndodhjes së rastit. Ajo do t’i përshkruajë palës tjetër provat në lidhje me natyrën dhe shkakun e ngjarjes dhe, gjithashtu, do t’i njoftojë asaj kthimin në kushte normale sa më shpejt që të jetë e mundur;

c) Palët do të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të zvogëluar pasojat e një rasti të Forcës Madhore.

### 2.6.4 Zgjatja e afatit

Çdo afat i parashikuar në kontratë, brenda të cilit njëra palë sipas kësaj kontrate duhet të kryejë një veprim apo detyrë, do të zgjatet për një afat të barabartë me periudhën gjatë së cilës kjo palë ishte në pamundësi për të përmbushur këto veprime si pasojë e Forcës Madhore, me kusht që afati i kontratës nuk do të zgjatet përtej afatit të rënë dakord në nenin 2.3.1.

#### 2.6.5 Konsultimi

Jo më vonë se njëzet (20) ditë pasi Kontraktuesi, për shkak të një rasti të Forcës Madhore, e ka të pamundur të kryejë një pjesë të rëndësishme të shërbimeve, palët do të konsultohen me njëra-tjetrën për të rënë dakord mbi masat e përshtatshme që duhen marrë, duke pasur parasysh rrethanat.

#### 2.7 Zgjidhja e kontratës

##### 2.7.1 Nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që, nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim, jo më të shkurtër se shtatëdhjetë (70) ditë, në adresë të Kontraktuesit, të zgjidhë këtë kontratë, pas ngjarjes së ndonjë prej rasteve të parashikuara në germa "a" deri në "e" në vijim:

a) Nëse Kontraktuesi nuk korrigjon një mospërbushje të detyrimeve të tij në këtë kontratë, sipas kërkesës së përcaktuar në njoftimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues, brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga marrja e këtij njoftimi ose brenda çdo afati tjetër të miratuar më tej me shkrim nga Autoriteti Kontraktues;

b) Nëse Kontraktuesi ndodhet në gjendjen e paafësisë paguese ose falimenton, ose lidh një marrëveshje me kreditorët e tij për administrimin e borxheve, ose përfiton nga ndonjë ligj në favor të debitorëve, ose shkon në likuidim apo administrim të detyrueshëm apo vullnetar;

c) Nëse Kontraktuesi nuk përmbush një vendim përfundimtar, të marrë si pasojë e procedurave të gjykatës ose të arbitrazhit sipas nenit 10 të kësaj kontrate;

d) Nëse, si pasojë e Forcës Madhore, Kontraktuesi nuk ka mundësi të përmbushë një pjesë të rëndësishme të shërbimeve për një kohëzgjatje jo më të shkurtër se shtatëdhjetë (70) ditë;

e) Nëse raporti tremujor i TKP-ve të pranuar që ka lidhje me raportin tremujor të fundit të vitit të parë të kontratës (viti i parë, tremujori i katërt) (i përmendur në seksionin 2 të shtojcës C), nuk pranohet nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me paragrafin 2.3 të seksionit 2 të shtojcës C.

##### 2.7.2 Nga Kontraktuesi

Kontraktuesi ka të drejtë që, nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim, jo më të shkurtër se shtatëdhjetë (70) ditë në adresë të Autoritetit Kontraktues, të zgjidhë këtë kontratë pas ndarjes së ndonjë prej rasteve të parashikuara në germa "a" deri në "e" në vijim:

a) Nëse Autoriteti Kontraktues nuk paguan detyrimet e tij ndaj Kontraktuesit sipas kushteve të kësaj kontrate, të cilat nuk janë objekt mosmarrëveshjeje sipas nenit 10 të saj, brenda dyzet e pesë (45) ditëve pas marrjes së një njoftimi me shkrim nga Kontraktuesi në lidhje me vonesën e pagesës;

b) Nëse Autoriteti Kontraktues nuk korrigjon një mospërbushje të detyrimeve të tij në këtë kontratë, sipas kërkesës së përcaktuar në njoftimin me shkrim të Kontraktuesit, brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga marrja e këtij njoftimi ose brenda çdo afati tjetër të miratuar më tej me shkrim nga Kontraktuesi;

c) Nëse si pasojë e Forcës Madhore, Kontraktuesi nuk mund të përmbushë një pjesë ose të gjitha shërbimet, për një periudhë jo më shkurtër se shtatëdhjetë (70) ditë;

d) Nëse Autoriteti Kontraktues nuk përmbush një vendim përfundimtar, të marrë si pasojë e procedurave të gjykatës ose arbitrazhit sipas nenit 10 më poshtë të kësaj kontrate;

e) Në përputhje me nenin 8.3 të kontratës.

##### 2.7.3 Përfundimi i të drejtave dhe detyrimeve

Me zgjidhjen e kësaj kontrate sipas nenit 2.7 ose mbarimit të afatit të saj sipas nenit 2.3, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve mbarojnë, me përjashtim të: 1) atyre të drejtave dhe detyrimeve të akumuluar në datën e zgjidhjes ose përfundimit të afatit të kësaj kontrate; 2) detyrimit të konfidencialitetit të parashikuar në nenin 3.2; ose 3) çdo të drejte ose detyrimi që një palë mund të ketë sipas neneve 1, 2, 3, 6, 10 dhe shtojcës C ose një dispozite tjetër të kësaj kontrate, që në mënyrë të shprehur ose jo, është bërë me qëllim për të hyrë në fuqi ose vazhduar efektin pas zgjidhjes ose mbarimit të afatit të kontratës.



#### 2.7.4 Përfundimi i shërbimeve

Me zgjidhjen e kësaj kontrate, përmes njoftimit të njëjës palë drejtuar palës tjetër sipas neneve 2.7.1 ose 2.7.2 të saj, Kontraktuesi, menjëherë me dërgimin ose marrjen e këtij njoftimi, do të marrë të gjitha masat për të përfunduar shërbimet e tij në mënyrë të menjëhershme dhe të rregullt dhe do të kryejë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të ulur nivelin e shpenzimeve për këtë qëllim në minimum. Në lidhje me dokumentet e përgatitura nga Kontraktuesi dhe pajisjet e materialet e furnizuara nga Autoriteti Kontraktues, Kontraktuesi do t'i kthejë menjëherë këto dokumente, pajisje ose materiale Autoritetit Kontraktues, me kusht që Kontraktuesi të mund të ruajë një kopje të të gjitha dokumenteve, vetëm për qëllime arkivimi, nën detyrimin e konfidencialitetit të parashikuar në nenin 3.2. Kontraktuesi ka detyrimin që, brenda 10 ditëve nga data e zgjidhjes, t'i kthejë Autoritetit Kontraktues të gjithë dokumentacionin ose materialet që përmbajnë informacion konfidencial, të cilat i janë vendosur në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues ose janë krijuar gjatë procesit të negociimit, lidhjes apo përmbushjes së kësaj kontrate.

#### 2.7.5 Pagesa me rastin e zgjidhjes së kontratës

Me zgjidhjen e kontratës sipas neneve 2.7.1 ose 2.7.2 të saj, pa cenuar asnjë të drejtë apo mjet korigjimi tjetër të palëve, Autoriteti Kontraktues do të kryejë pagesat e mëposhtme ndaj Kontraktuesit, brenda një afati maksimal prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e faturës së Kontraktuesit, për këtë qëllim:

a) Shpërblimin sipas nenit 6 dhe shtojcës C bashkëngjitur për shërbimet e kryera përpara datës efektive të zgjidhjes, të llogaritur në atë mënyrë që Kontraktuesi të përfitojë një shumë të barabartë me vlerën e kontratës, të pjesëtuar me 24 dhe shumëzuar me numrin e muajve që kanë kaluar nga data e fillimit të shërbimeve, deri në muajin në të cilin bie data e zgjidhjes së kontratës (duke e përfshirë atë muaj); dhe

b) Në rast të zgjidhjes së kontratës sipas paragrafëve (d) dhe (e) të neneve 2.7.1 dhe 2.7.2 të saj, Autoriteti Kontraktues do të kryejë: i) një pagesë rimbursimi ndaj Kontraktuesit për të gjitha kostot dhe shpenzimet e kryera në përgatitet për mobilizimin e kontratës; ii) rimbursimin e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të lidhura me zgjidhjen e menjëhershme dhe të rregullt të kontratës, duke përfshirë të gjitha kostot e shpenzimet e parikuperueshme të kryera nga Kontraktuesi; iii) një pagesë për Kontraktuesin, të barabartë me shumën e çdo angazhimi të marrë përsipër nga Kontraktuesi kundrejt palëve të treta (duke përfshirë të gjitha pagesat për personelin e Kontraktuesit, qiratë për ambientet e zyrave dhe akomodimin dhe qiratë për pajisjet); dhe iv) rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit të kthimit të personelit të huaj të Kontraktuesit.

#### 2.7.6 Mosmarrëveshjet për rastet e zgjidhjes

Nëse njëra palë nuk është dakord se ka ndodhur ndonjë prej rasteve të parashikuar në germa "a" deri në "e" të nenit 2.7.1 ose germa "a" deri në "e" të nenit 2.7.2, atëherë kjo palë ka të drejtë që brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga marrja e njoftimit të zgjidhjes nga pala tjetër, ta referojë këtë mosmarrëveshje në arbitrazh sipas nenit 10 të kësaj kontrate, dhe kjo kontratë nuk do të zgjidhet për shkak të rastit specifik, përveçse në përputhje me kushtet e vendimit të gjykatës së arbitrazhit.

### 3. DETYRIMET E KONTRAKTUESIT

#### 3.1 Të përgjithshme

##### 3.1.1 Standardet e performancës

Kontraktuesi do t'i kryejë shërbimet dhe detyrimet e tij në këtë kontratë, duke treguar të gjithë kujdesin e arsyeshëm dhe në përputhje me praktikën dhe teknikat profesionale të pranuar përgjithësisht (sipas referimit në Bluprintet e doganave të Komisionit Evropian të zbatueshme në datën e kësaj kontrate). Ai do të aplikojë praktika të shëndosha menaxhimi dhe do të vendosë në punë metoda, materiale, pajisje dhe makineri të sigurta dhe efektive. Kontraktuesi do të veprojë gjithmonë, në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me këtë kontratë ose shërbimet, si këshilltar besnik i Autoritetit Kontraktues, dhe në çdo kohë që do të ofrojë shërbimet, do të mbështesë dhe ruajë interesat legjitime të Autoritetit Kontraktues në çdo marrëveshje me palë të treta.

### 3.2 Konfidencialiteti

3.2.1 As Autoriteti Kontraktues, as Kontraktuesi dhe as personeli i tyre nuk do të zbulojnë informacione konfidenciale dhe të ruajtur nga pronësia intelektuale në lidhje me shërbimet ose këtë kontratë, pa miratimin paraprak të të dyja palëve. Për qëllimin e kësaj kontrate, “informacioni konfidencial” nënkupton çdo informacion, i cili gjykohet si konfidencial nga një person i arsyeshëm biznesi në lidhje me:

- a) biznesin, punët, klientët, furnitorët ose projektet e njëres palë (ose çdo anëtar i grupit të shoqërive, të cilit kjo palë i përket);
- b) operacionet, proceset, produktet ose informacionin e shërbimit, *Know-how*, dizenjo, sekrete tregtare ose *software* të njëres palë (ose çdo anëtar i grupit të cilit kjo palë i përket); ose
- c) çdo informacion të zhvilluar nga palët gjatë përmbushjes së kësaj kontrate.

3.2.2 Të drejtat e autorit dhe pronësisë intelektuale në të gjitha dokumentet, raportet, përlllogaritjet, specifikimet dhe materialet e tjera të siguruara ose të zhvilluara nga Kontraktuesi ose personeli i tij mbeten në pronësinë e vetme të Kontraktuesit, i cili nëpërmjet kësaj kontrate, i ofron Autoritetit Kontraktues të drejtën joekskluzive dhe të patransferueshme për të përdorur këto dokumente, raporte, përlllogaritje, specifikime dhe materialet e tjera, vetëm për qëllimet e kësaj kontrate në Shqipëri.

3.2.3 Kontraktuesi nuk ka të drejtë që, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues (i cili nuk mund të shmanget apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme), të botojë i vetëm ose në bashkëpunim me një person apo entitet tjetër ndonjë artikull, fotografi apo ilustrim në lidhje me shërbimet dhe/ose të përfshijë një përshkrim të kontratës dhe shërbimeve në dokumentacione marketimi apo tenderimi.

### 3.3 Përgjegjësia e Kontraktuesit

a) Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për dëme indirekte ose humbje që vijnë si pasojë në përputhje me nenin 3.3 (c) vijues.

b) Përgjegjësia maksimale e Kontraktuesit, në përputhje me nenin 3.3 (c) në lidhje me këtë kontratë, do të kufizohet në shumën maksimale prej 3.167.790 (tre milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë eurosh) në total. Ky kufizim do të zbatohet pavarësisht shkakut të përgjegjësisë, qoftë për shkak të shkeljes së kontratës, dëmit jashtëkontraktor (duke përfshirë dëmin jashtëkontraktor për shkak të pakujdesisë), pakujdesisë së tepruar apo shkeljes së detyrimeve ligjore.

c) Ky nen 3.3 nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e Kontraktuesit për shkak të vdekjes ose dëmtimit personal, të shkaktuar për shkak të pakujdesisë së Kontraktuesit ose për shkak të mashtrimit apo deklarimit mashtrues.

d) Në rastin e pretendimeve të ngritura në një gjykatë shqiptare kundër Kontraktuesit nga palë të treta, me të cilat Kontraktuesi nuk ka një marrëdhënie kontraktuale, në lidhje me përmbushjen e shërbimeve, të cilat Kontraktuesi i ka kryer në mirëbesim dhe në përputhje me nenin e kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues do të ndihmojë dhe mbështesë Kontraktuesin në mbrojtjen e pretendimeve të tilla, sipas ligjit shqiptar, duke përfshirë dhe marrjen përsipër të mbrojtjes, me përjashtim të rasteve që lidhen me dashjen apo pakujdesinë e tepruar nga ana e Kontraktuesit.

e) Autoriteti kontraktues do të dëmshpërblejë Kontraktuesin për të gjitha përgjegjësitë, kostot, shpenzimet, dëmet dhe humbjet (duke përfshirë të gjitha humbjet direkte ose indirekte, fitimin e munguar, dëmtimin e reputacionit dhe të gjitha interesat, penalitetet dhe shpenzimet ligjore (të llogaritura në mënyrë të plotë) dhe të gjitha shpenzimet dhe kostot e tjera profesionale) në ngarkim të Kontraktuesit ose të paguara prej tij, që kanë ardhur si pasojë e ose në lidhje me:

i) shkeljen prej Autoritetit Kontraktues të ndonjë prej garancive dhe deklarimeve të kësaj kontrate;

ii) mospërmbushjen ose përmbushjen me pakujdesi të kësaj kontrate nga Autoriteti Kontraktues;



- iii) zbatimin e kësaj kontrate;
- iv) çdo pretendim kundër Kontraktuesit për shkeljen e pretenduar ose të faktit të të drejtave të pronësisë intelektuale të palëve të treta, e cila lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen nga Kontraktuesi të shërbimeve në përputhje me nenet e kësaj kontrate;
- v) çdo pretendim kundër Kontraktuesit nga një palë e tretë, i cili lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen e shërbimeve nga Kontraktuesi në përputhje me nenet e kësaj kontrate;
- vi) çdo pretendim kundër Kontraktuesit nga një palë e tretë për vdekjen, dëmtimin personal ose dëmtimin e pasurisë që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen e shërbimeve nga Kontraktuesi, në përputhje me nenet e kësaj kontrate.

#### 3.4. Detyrimet e raportimit

Kontraktuesi do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues raportet dhe dokumentet e përcaktuara në shtojcën C bashkëngjitur, sipas modelit, shifrave dhe afateve të parashikuara në të njëjtën shtojcë.

#### 4. Personeli i Kontraktuesit

##### 4.1 Të përgjithshme

Kontraktuesi do të punësojë dhe ofrojë një personel të kualifikuar dhe me eksperiencën e duhur të kërkuar për kryerjen e shërbimeve.

##### 4.2 Miratimi i personelit

Personeli i listuar sipas funksioneve, si dhe sipas emrit, në shtojcën H është miratuar rregullisht nga Autoriteti Kontraktues. Në lidhje me personelin të cilin Kontraktuesi do ta propozojë për ta përdorur në funksion të ofrimit të shërbimit, duhet t'i paraqesë kryetarit të KMP-së për shqyrtim dhe miratim me shkrim një kopje të të dhënave biografike. Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që kryetari i KMP-së nuk do të mbajë apo vonojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin me shkrim të personelit. Nëse kryetari i KMP-së nuk kundërshton me shkrim (duke deklaruar arsyet e kundërshtimit), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së të dhënave biografike, personeli do të konsiderohet se është miratuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### 5. Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

##### 5.1 Detyrimi për ndihmë

5.1.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues do t'i ofrojë kontraktuesit të gjithë ndihmën dhe bashkëpunimin që mund t'i nevojitet atij për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës dhe, të kërkuar nga Kontraktuesi rast pas rasti, në lidhje me:

- a) sigurimin e lejeve të punës, qëndrimit apo lejeve të tjera dhe vizave të kërkuara sipas ligjit shqiptar për përmbushjen nga Kontraktuesi dhe personeli i tij i huaj të detyrimeve të kësaj kontrate;
- b) sigurimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit për familjarët e personelit të huaj të Kontraktuesit, për t'i lejuar ata që të qëndrojnë në Shqipëri gjatë kohës në të cilën anëtarët përkatës të personelit të huaj qëndrojnë në Shqipëri, me qëllim kryerjen e detyrimeve të kësaj kontrate;
- c) zhdoganimin pa vonesë në dogana të çdo malli të importuar, për shkak të shërbimeve ose për nevojat personale të personelit të huaj dhe familjarëve të tyre;
- d) lëshimin nga Autoriteti Kontraktues brenda kompetencave të tij ligjore, të urdhrave dhe udhëzimeve të nevojshme për organet dhe zyrtarët në varësi të tij, të cilat janë të nevojshme për implementimin e shërbimeve;
- e) ofrimin e ndihmës për personelin e huaj të Kontraktuesit, në lidhje me sjelljen në Shqipëri të shumave të arsyeshme në monedhë të huaj për qëllimet e shërbimit ose eksportin e shumave të fituara nga personeli i huaj, për shkak të ekzekutimit të shërbimeve sipas legjislacionit të zbatueshëm shqiptar.

##### 5.1.2 Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, Autoriteti Kontraktues:

- a) do t'i ofrojë Kontraktuesit dhe personelit të tij, të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme që kërkohen për përmbushjen e shërbimeve dhe do t'i ofrojë Kontraktuesit asistencën e nevojshme për kryerjen e shërbimeve;



b) do të marrë vendime në lidhje me specifikimet, rekomandimet e raportuara dhe çështje të tjera të referuara tek Autoriteti Kontraktues për vendimmarrje brenda një kohe të arsyeshme, e cila nuk vonon apo pengon përmbushjen e shërbimeve;

c) do t'i ofrojë Kontraktuesit të gjitha lejet e aksesit dhe do t'i garantojë atij akses të lirë dhe të papenguar në ambientet e tij, i cili është i nevojshëm për kryerjen e shërbimeve dhe implementimin e kushteve të kontratës;

d) do të sigurojë që këshilli i menaxhimit të programit të krijohet brenda 10 ditëve nga data e fillimit të shërbimit, me përfaqësues të përshtatshëm të Autoritetit Kontraktues, dhe të njoftojë përkatësisht Kontraktuesin dhe do të sigurojë që këshilli i menaxhimit të programit të funksionojë në mënyrë efektive dhe takohet rregullisht sipas kërkesës së secilës palë, dhe të paktën çdo muaj gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës;

e) do të sigurojë që lejet, autorizimet dhe miratimet e nevojshme të kërkuara nga organet përkatëse shqiptare, sipas ligjit të zbatueshëm shqiptar, do t'i lëshohen pa vonesa Kontraktuesit (nëse është e nevojshme nëpërmjet këshillit të menaxhimit të programit), për t'i mundësuar Kontraktuesit përmbushjen e shërbimeve dhe pagesën për to; dhe

f) do të sigurojë që një numër i përshtatshëm i zyrtarëve dhe stafit ndihmës të doganave shqiptare (të cilët do të zgjidhen në konsultim me Kontraktuesin) të vendosen në dispozicion të Kontraktuesit.

## 5.2 Pagesat

Për të gjitha shërbimet e kryera nga Kontraktuesi sipas kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues do t'i ofrojë Kontraktuesit shpërblimin e rënë dakord në nenin 6 të kontratës, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë nen.

## 5.3 Zyrat, pajisjet teknike dhe lehtësi të tjera

Për qëllimet e kryerjes së shërbimeve nga Kontraktuesi, Autoriteti Kontraktues do t'i ofrojë Kontraktuesit pa pagesë, duke filluar nga data e fillimit të shërbimit, zyrat, automjetet, pajisjet dhe lehtësitë e tjera të përcaktuara në shtojcën B.

## 6. Pagesat për Kontraktuesin

6.1.1 Vlera totale e tarifave dhe shpenzimeve të drejtpërdrejta për vitin e parë nuk do të kalojë shumë 4,250,000 euro (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë euro), plus koston e furnizimit dhe vënies në përdorim të 10 (dhjetë) automjeteve operationale (deri në një shumë limit prej 400.000 eurosh) në përputhje me nenin 6.1.4. Vlera e përgjithshme e tarifave dhe e shpenzimeve të drejtpërdrejta për vitin e dytë të kontratës nuk do të kalojë shumë 4,250,000 euro (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë euro). Në rast se Autoriteti Kontraktues i jep Kontraktuesit njoftimin për zgjatjen e afatit të kontratës (viti i 3-të) në përputhje me nenin 2.3.2, vlera e përgjithshme e tarifave dhe e shpenzimeve të drejtpërdrejta për vitin e 3-të të kontratës nuk do të kalojë shumë 4,250,000 euro (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë euro), plus TVSH-në (nëse zbatohet) sipas saktësisht në tabelën e pagesave të Kontraktuesit, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate në shtojcën C dhe nenin 6.1.4.

6.1.2 Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit, sipas këtij neni dhe nenit 2.1 një paradhënie të barabartë me 10% të vlerës së tarifave dhe shpenzimeve të drejtpërdrejta për vitin e parë dhe të dytë të kontratës (pagesa e paradhënies), për të mbuluar mobilizimin dhe kostot e tjera, pas marrjes nga Autoriteti Kontraktues të garancisë së paradhënies të pagesës nga Kontraktuesi të lëshuar nga Crown Agent Bank Limited (Banka CA), një bankë në Mbretërinë e Bashkuar, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën F, së bashku me një faturë për pagesën e paradhënies. Pagesa e paradhënies do të sigurohet paraprakisht nga garancia e paradhënies së përmendur më sipër sipas modelit të përcaktuar në shtojcën F. Në rastin e përfundimit të parakohshëm të kontratës sipas nenit 2.7, pagesa e paradhënies do të paguhet duke zbritur 1/24 e shumës në fjalë për çdo muaj apo pjesë të tij përtej datës së fillimit të shërbimeve të kontratës.





6.1.3 Pagesa e mbetur, e barabartë me 90% të vlerës së përgjithshme të tarifave dhe shpenzimeve të drejtpërdrejta për vitin e parë dhe të dytë të kontratës, do të bëhet çdo muaj nga Autoriteti Kontraktues në euro, pas paraqitjes nga Kontraktuesi të 24 faturave mujore për shumat e pagesave mujore të përcaktuara në kolonën e 3-të të tabelës së pagesave në nenin 1 të shtojcës C, plus TVSH-në (nëse zbatohet), duke zbritur ripagimin e pagesës së paradhënies sipas saktësisimit në kolonën e 2-të të planit të pagesave dhe mbajtjet e përcaktuara në shtojcën C, të cilat janë të pagueshme sipas kushteve të nenit 2 të shtojcës C. Autoriteti Kontraktues duhet të shlyejë faturat mujore të paraqitura nga Kontraktuesi brenda një periudhe maksimale prej 30 (tridhjetë) ditëve nga data e faturës përkatëse. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e njofton Kontraktuesin me shkrim për refuzimin e faturës, brenda një periudhe prej 10 (dhjetë) ditësh pas datës së faturës të marrë nga Autoriteti Kontraktues, ajo do të konsiderohet e pranuar nga Autoriteti Kontraktues. Pagesa do të sigurohet nga një letër e konfirmuar dhe e transferueshme e gatshme e kredisë, sipas modelit të bashkëngjitur në shtojcën D të lëshuar nga banka [ ], Shqipëri dhe e konfirmuar në mënyrë të rregullt nga banka [ ], Londër, vlera e së cilës nuk do të jetë më pak se shuma që përfaqëson 3 pagesa mujore sipas këtij neni. Nëse Kontraktuesi paraqet një pretendim sipas kushteve të letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (ose nëse letra e konfirmuar e transferueshme dhe e gatshme e kredisë është afër skadimit përpara përfundimit të kontratës për ndonjë arsye), atëherë Autoriteti Kontraktues do të sigurojë rinovimin e saj (në rastin e skadimit, për një periudhë shtesë të barabartë me kohëzgjatjen e kontratës + gjashtë muaj) ose do të rrisë përsëri vlerën me një shumë të barabartë që përfaqëson 3 pagesa mujore sipas këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pretendimi (dhe/ose në rastin e skadimit, të paktën një muaj përpara skadimit). Çdo mangësi në përmbushjen e këtij detyrimi për rinovimin e afatit apo rritjen e vlerës së letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë, përbën një shkelje të kontratës, e cila nuk mund të korrigjohet dhe i jep kontraktuesit të drejtën që ta zgjidhë kontratën sipas nenit 2.7.2 (b).

Mbajtjet do të llogariten në referencë me përqindjet e vlerës së përgjithshme të tarifave mujore të Kontraktuesit dhe në përputhje me treguesit kryesorë të performancës të mëposhtëm.

Zbritjet nga të ardhurat mujore të synuara	10%
Zbritjet mujore të performancës	10%
Zbritjet nga pragu mujor	5%

Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të arsyeshme për të rënë dakord dhe nënshkruar TKP-të e pranuar brenda një muaji nga data e fillimit të shërbimeve, në përputhje me procedurat e parashikuara në shtojcën C, me kushtin që TKP-të e pranuar për zbritjet nga të ardhurat mujore të synuara, do të bazohen në një rritje të pranuar në shumën e përgjithshme të të ardhurave të mbledhura nga administrata doganore, shprehur si një përqindje e prodhimit kombëtar bruto të Shqipërisë.

6.1.4 Së bashku me shërbimet, Kontraktuesi do të sigurojë dhe vendosë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues (në një apo më shumë dërgesa) 10 automjete operationale (automjetet). Të gjitha automjetet do të sigurohen dhe vendosen në dispozicion e përdoren për veprime operationale (të personalizuar me shenja dhe me pajisjet e nevojshme, duke përfshirë dritat vezulluese dhe sistemet zanore shtesë) nga Kontraktuesi në bashkërendim me Autoritetin Kontraktues dhe ky i fundit do t'i paguajë Kontraktuesit koston aktuale të furnizimit dhe dorëzimit të automjeteve (me kushtet e livrimit DDP Tiranë, sipas Inkoterms<sup>®</sup> 2010). Vlera maksimale për livrimin dhe dorëzimin e automjeteve është 400,000 euro (katërqind mijë euro). Për të shmangur çdo dyshim, kostoja aktuale në lidhje me livrimin dhe dorëzimin e automjeteve (deri në një vlerë maksimale prej 400,000 eurosh) do t'i paguhet Kontraktuesit nga Autoriteti Kontraktues mbi vlerën e përgjithshme të kontratës për tarifa dhe kostot direkte sipas nenit 6.1.1. Kontraktuesi nuk do të nënshkruajë asnjë kontratë për blerjen e automjeteve, deri në momentin kur Autoriteti Kontraktues do t'i ketë siguruar Kontraktuesit: i) pagesën prej 400,000 eurosh, duke ia kaluar në llogari si fond i lirë (fondi i automjeteve); ose ii) letrën e konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (automjetet)

thelbësisht sipas modelit bashkëngjitur në shtojcën L (dhe sipas një forme përfundimtare të pranueshme nga Kontraktuesi, pranim përfundimtar ky, i cili t'i jetë konfirmuar me shkrim Autoritetit Kontraktues nga Kontraktuesi), të lëshuar nga \_\_\_\_ [Banka], Shqipëri dhe konfirmuar rregullisht \_\_\_\_ [Banka], Londër, e cila mund të tërhiqet nga Kontraktuesi në ose pas datës 21 janar 2014, në shumën prej 400,000 eurosh. Autoriteti Kontraktues do t'i sigurojë, ose: i) fondin e automjeteve; ose ii) letrën e konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (automjetet) Kontraktuesit, brenda 10 ditëve nga data e fillimit të shërbimeve. Automjetet e livruara do të jenë të pajisura me garancinë standarde të prodhuesit dhe Kontraktuesi nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për automjetet. Kontraktuesi do t'i paraqesë faturën apo faturat (në lidhje me një apo më shumë dërgesa të automjeteve) Autoritetit Kontraktues për automjetet e livruara menjëherë me dorëzimin e tyre, duke e njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues se automjetet janë gati për t'u livruar në një parkim të sigurt dhe mjedise të tipit garazh të Autoritetit Kontraktues, siç parashikohet në shtojcën B. Faturat do të paguhet: i) menjëherë me paraqitjen e tyre, nëse pagesa do të kryhet nga fondi i automjeteve; ose ii) maksimumi brenda datës 21 janar 2014, si afat i fundit dhe, nëse ndonjë nga faturat do të mbetet e papaguar pas datës 21 janar 2014, Kontraktuesi mund të parashtrijë një apo disa kërkesa sipas letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (automjetet). Nëse letra e konfirmuar e transferueshme dhe e gatshme e kredisë (automjetet) është pranë afatit të skadimit përpara datës së kryerjes së pagesës së plotë për automjetet dhe livrimin e tyre (për çdo arsye), Autoriteti Kontraktues do të sigurojë rinovimin e saj për një afat tjetër të paktën 3-mujor (të paktën një muaj përpara datës së skadimit). Çdo mospërbushje detyrimi nga ana e Autoritetit Kontraktues në lidhje me rinovimin e letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (automjetet) përbën shkelje të kontratës, e cila nuk mund të riparohet dhe i jep të drejtën Kontraktuesit të zgjidhë kontratën në përputhje me nenin 2.7.2 (b).

Automjetet do të mbeten në pronësi dhe administrimin e përditshëm të Kontraktuesit ose të filialit të Crown Agents në Shqipëri deri në përfundimin apo zgjidhjen e kontratës. Me përfundimin e kontratës sipas nenit 2.7 më sipër apo me zgjidhjen e saj sipas nenit 2.3 më sipër dhe me kushtin që Kontraktuesi të ketë marrë pagesën e plotë për automjetet sipas nenit 6.1.4, titulli i pronësisë dhe rrezikët që e shoqërojnë atë mbi automjetet do t'i transferohet Autoritetit Kontraktues.

6.1.5 Të gjitha shumat e pagueshme sipas kësaj kontrate nuk e përfshijnë TVSH-në.

6.1.6 Të gjitha pagesat në favor të Kontraktuesit, si shpërblim për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, duhet t'i bëhen Kontraktuesit në mënyrë të plotë, pa asnjë zbritje për kompensim ose pretendim të çdo lloji, dhe duhet të jenë të lira dhe të çliruara nga çdo zbritje apo mbajtje në burim, në numrin e llogarisë së kontraktuesit/filialit në Shqipëri i Crown Agents.

6.1.7 Nëse ndonjë shumë mbetet e papaguar, 45 ditë pas datës së duhur të pagesës, do të aplikohet dhe bëhet i pagueshëm ndaj Kontraktuesit një interes mbi shumën në fjalë, i barabartë me 3% në vit mbi normën e zbatueshme të rifinancimit të Bankës Qendrore Evropiane, që do të jetë në fuqi rast pas rasti, deri në momentin e kryerjes së pagesës.

6.1.8 Nëse Autoriteti Kontraktues kundërshton ndonjë shumë të përcaktuar në ndonjë faturë, ai duhet të paguajë pjesën e pakundërshtuar brenda afatit të përcaktuar për pagesën dhe palët do të përpiqen që në mirëbesim të zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet për shumat e kundërshtuara në përputhje me nenin 10 (zgjidhja e mosmarrëveshjeve). Në rast se mosmarrëveshja zgjidhet në favor të Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë menjëherë shumën e kundërshtuar plus interesin mbi këtë shumë në përputhje me nenin 6.1.7 të kontratës. Në rast se mosmarrëveshja është zgjidhur në favor të Autoritetit Kontraktues, Kontraktuesi duhet t'i lëshojë Autoritetit Kontraktues një notë për njohjen e detyrimit (notë kredie) në lidhje me shumën e kundërshtuar.

6.1.9 Pa cenuar ndonjë të drejtë tjetër riparimi ose zgjidhje që Kontraktuesi gëzon sipas kësaj kontrate, nëse Autoriteti Kontraktues nuk i paguan Kontraktuesit ndonjë detyrim në datën e caktuar, Kontraktuesi mund të pezullojë të gjitha shërbimet, derisa pagesa e detyrimit të bëhet në mënyrë të plotë. Autoriteti Kontraktues do t'i rimbursojë Kontraktuesit çdo kosto dhe shpenzim të



arsyeshëm që lidhet me pezullimin dhe rifillimin e menjëhershëm të shërbimeve sipas kontratës, duke përfshirë kostot e parikuperueshme të Kontraktuesit dhe kostot e udhëtimit ndërkombëtar vajtje-ardhje të personelit të huaj të Kontraktuesit.

6.1.10 Kontraktuesi ka të drejtë që në çdo kohë, të kompensojë çdo detyrim të Autoritetit Kontraktues për Kontraktuesin me çdo detyrim të Kontraktuesit për Autoritetin Kontraktues, qoftë ky detyrim ekzistues, apo i ardhshëm, i shlyer ose i pashlyer, që bazohet ose jo në këtë kontratë. Nëse detyrimet për kompensim janë të shprehura në monedha të ndryshme, Kontraktuesi mund të konvertojë secilin prej detyrimeve me normën e këmbimit valutor të tregut për qëllim të kompensimit. Çdo ushtrim nga ana e Kontraktuesit e të drejtave të tij sipas këtij neni, nuk kufizon ose cenon të drejtat e tjera ose të riparimit që ai gëzon sipas kësaj kontrate ose për shkak tjetër.

#### 7 Mashtrimi, antikorrupsioni dhe korrupsioni

7.1.1 Palët do të zbatojnë standardet më të larta të etikës në përmbushjen e kësaj kontrate.

7.1.2 Asnjëra nga palët nuk ofron dhe as do të ofrojë, paguajë, kërkojë, autorizojë, bashkëpunojë ose pranojë pagesën ose marrjen e mitës (duke përfshirë edhe të ashtuquajturat “përfitime të padrejta”) në çdo vend të botës nga çdo person për llogari të saj ose për përfitimin e saj të çfarëdolloj natyre. Edhe vetëm sugjerimi i mitmarrjes ose korrupsionit mund të dëmtojë seriozisht reputacionin e Autoritetit Kontraktues dhe të Kontraktuesit dhe/ose klientëve ose partnerëve të tyre të biznesit, të ndikojnë në aftësinë e tyre për të ushtruar aktivitetet dhe të dëmtojë reputacionin e punonjësve të tyre. Palët angazhohen të ndajnë informacion dhe të forcojnë veprimet kolektive për të eliminuar mashtrimin, mitmarrjen dhe korrupsionin.

7.1.3 Secila nga palët e kësaj kontrate do të veprojnë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kodet kundër mitmarrjes dhe korrupsionit, të zbatueshme në vendet në të cilat ushtrojnë veprimtarinë dhe në rastet kur ligjet, kodet dhe rregulloret janë të zbatueshme edhe jashtë vendeve të origjinës (për shembull, akti i korrupsionit 2010 të Mbretërisë së Bashkuar dhe akti mbi praktikën e huaja korruptive 1977 të SHBA-së), në të gjitha ato vende ku këto ligje, kode dhe rregullore kundër mitmarrjes dhe korrupsionit janë të zbatueshme.

7.1.4 Secila nga palët do të njoftojë menjëherë palën tjetër për çdo kërkesë ose pretendim të padrejtë për avantazh financiar ose çdo avantazhi tjetër të marrë nga pala në fjalë në lidhje me përmbushjen e kësaj kontrate ose çdo dyshim që mund të ketë pala në fjalë në lidhje me sa më sipër.

7.1.5 Secila nga palët do të raportojë në konfidencë, sa më shpejt që të jetë e mundur, çdo dyshim në lidhje me veprimtari të mundshme korruptive të personelit të palës tjetër ose personave të lidhur me palën tjetër.

7.1.6 Të dyja palët njohin përgjegjësitë e tyre për të parandaluar dhe luftuar mitmarrjen dhe korrupsionin dhe zotohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë etike dhe me integritet të plotë dhe të implementojnë dhe mirëmbajnë sisteme të mirëqeverisjes efektive, transparencës, llogaridhënies dhe raportimit, në mënyrë që të parandalojnë dhe luftojnë mitmarrjen dhe korrupsionin në çdo formë në aktivitetet e tyre të jashtme dhe të brendshme.

7.1.7 Çdo shkelje e detyrimeve të nenit 7 do të quhet si shkelje e kësaj kontrate, e cila nuk mund të riparohet dhe i jep të drejtën palës që nuk ka bërë shkelje, të zgjidhë këtë kontratë në përputhje me nenin 2.7.1 (a) ose 2.7.2 (b) sipas rastit.

#### 8. Ndershmëria dhe mirëbesimi

##### 8.1 Mirëbesimi

Palët angazhohen të veprojnë në mirëbesim në lidhje me të drejtat e njëra-tjetrës sipas kësaj kontrate dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur realizimin e qëllimeve të kësaj kontrate.

##### 8.2 Veprimi i kontratës

Palët pranojnë se nuk është e mundur që në këtë kontratë të parashikohet çdo çështje që mund të lindë gjatë kohëzgjatjes së saj. Palët bien dakord se është qëllimi i tyre që kontrata të veprojë ndershmërisht midis tyre dhe pa shkelur interesat e njëra-tjetrës. Në qoftë se gjatë

kohëzgjatjes së saj, ndonjëra nga palët gjykon se kjo kontratë po vepron në mënyrë të pandershme, palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të rënë dakord në veprimet, të cilat mund të jenë të nevojshme për të eliminuar shkakun ose shkaqet e kësaj pandershmërie. Por pamundësia për të rënë dakord për veprimet që mund të jenë të nevojshme sipas këtij neni, nuk do të përbëjë shkak për mosmarrëveshje që janë objekt zgjidhje nga gjykata ose arbitrazhi në përputhje me nenin 10 më poshtë.

8.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi ndaj Autoritetit Kontraktues për vonesa, në qoftë se kontrata është ndikuar negativisht ose vonuar për shkak të veprimit(eve) të zyrtarëve të Autoritetit Kontraktues ose palëve të treta që kanë për qëllim të dëmtojnë objektin ose synimet e kësaj kontrate, dhe të dyja palët do të punojnë në mënyrë të kujdesshme për të paraprirë ose shmangur çdo veprim të tillë. Në rast se kjo nuk realizohet, Kontraktuesit i lind e drejta që, në diskrecionin e tij absolut, të zgjidhë kontratën në përputhje me nenin 2.7.2 (e).

8.4 Autoriteti Kontraktues i zotohet Kontraktuesit se (me përjashtim të rasteve kur Kontraktuesi ka dhënë pëlqimin me shkrim) ai dhe entitetet e lidhura me të, në mënyrë direkte ose indirekte, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate dhe, gjithashtu, për një afat 18-mujor pas përfundimit të saj, nuk do të ofrojë punësim ose ofrojë lidhjen e kontratave të shërbimit, ose të punësojë ndonjë prej punonjësve ose konsulentëve të Kontraktuesit, ose të sigurojë ose lehtësojë bërjen e ofertave të tilla nga çdo person, firmë ose shoqëri, ose të nxitë ose të mundësojë nxitjen që këta punonjës ose konsulentë të zgjidhin marrëveshjen ose punësimin e tyre me Kontraktuesin.

8.5 Autoriteti Kontraktues bie dakord se Crown Agents Limited mund të themelojë filialin e tij në Shqipëri dhe në këtë rast, Autoriteti Kontraktues, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim nga Crown Agents Limited, e shoqëruar nga një garanci e shoqërisë mëmë në lidhje me përgjegjësinë, të drejtat dhe detyrimet e filialit, hartuar sipas modelit që miratohet në shtojcën J, të ofruar nga Crown Agents Limited.

## 9. Procedura e ndryshimit

9.1 Për qëllimet e kësaj kontrate, një kërkesë për ndryshim është:

a) një kërkesë për të ndryshuar (duke përfshirë pushimin) e një pjese të shërbimeve ose për të shtuar shërbime të reja në to; ose

b) një kërkesë për të ndryshuar këtë kontratë ose çdo dokument bashkëngjitur asaj, ose referuar në këtë kontratë (duke përfshirë TKP-të e pranuar).

9.2 Një kërkesë për ndryshim do të shndërrohet në një “urdhër për ndryshim”, kur janë përmbushur kushtet dhe kërkesat e procedurës për ndryshimin e kontrollit dhe kërkesa për ndryshim të jenë nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të Autoritetit Kontraktues dhe përfaqësuesit e autorizuar të Kontraktuesit, duke nënkuptuar miratimin e tyre për ndryshimin. Një urdhër ndryshimi do të përbëjë një ndryshim të kontratës sipas nenit 2.5 më sipër.

## 9.3 Origjina e kërkesës për ndryshim

a) Një kërkesë për ndryshim mund të bëhet si nga Autoriteti Kontraktues, ashtu edhe nga Kontraktuesi.

b) Në rast se kërkesa për ndryshim bëhet nga Kontraktuesi, atëherë ai duhet të paraqesë, së bashku me kërkesën për ndryshim, qëllimin teknik të ndryshimit të propozuar, si dhe detajet e ndikimit që ky ndryshim i propozuar mund të ketë mbi: i) shërbimet; ii) çdo sistem ose veprimtari të Autoritetit Kontraktues që komunikon ose preket nga shërbimet; iii) vlerën totale të kontratës dhe planin e pagesave në shtojcën C; dhe iv) kushtet e tjera të kësaj kontrate (duke përfshirë detyrimet e Autoritetit Kontraktues sipas nenit 5).

c) Në rast se kërkesa për ndryshim bëhet nga Autoriteti Kontraktues, Kontraktuesi do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për ndryshim, qëllimin teknik të ndryshimit të propozuar dhe detajet e ndikimit që ky ndryshim i propozuar do të ketë mbi: i) shërbimet; ii) çdo sistem ose veprimtari të Autoritetit Kontraktues që komunikon ose preket nga shërbimet; iii) vlerën totale të kontratës dhe planin e pagesave në shtojcën C; dhe iv) kushtet e tjera



të kësaj kontrate (duke përfshirë detyrimet e Autoritetit Kontraktues sipas nenit 5).

#### 9.4 Marrëveshja e urdhrave të ndryshimit

a) Me përjashtim të rastit kur është parashikuar ndryshe në këtë kontratë, asnjë nga palët nuk është e detyruar të bjerë dakord me kërkesën për ndryshim të bërë nga pala tjetër.

b) Në qoftë se asnjëra nga palët nuk është e gatshme të pranojë një kërkesë për ndryshim të propozuar nga pala tjetër (ose ndonjë kusht të urdhrit të ndryshimit), atëherë pala tjetër mund të kërkojë që kjo mosmarrëveshje të zgjidhet në përputhje me procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas nenit 10.

#### 9.5 Kostot e zbatimit

Kostot për zbatimin e urdhrit të ndryshimit do të mbulohen sipas përcaktimeve në vetë urdhrin përkatës të ndryshimit.

#### 10. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

##### 10.1 Zgjidhja miqësore

Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur miqësisht të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin nga ose në lidhje me këtë kontratë ose interpretimin e saj.

##### 10.2 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me një çështje të kësaj kontrate, e cila nuk mund të zgjidhet miqësisht brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja prej njëres palë të kërkesës së palës tjetër për zgjidhjen në mënyrë miqësore, mund të parashtrohet nga secila palë për zgjidhje sipas dispozitave të mëposhtme:

##### 10.2.1 Zgjedhja e arbitrave

Çdo mosmarrëveshje e paraqitur nga njëra palë në arbitrazh, do të dëgjohet nga një arbitër i vetëm ose një panel arbitrash i përbërë nga tre arbitra, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

a) Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi do të caktojnë secili nga një arbitër dhe këta dy arbitra do të caktojnë së bashku një arbitër të tretë, i cili do të drejtojë panelin e arbitrave. Në qoftë se arbitrat e caktuar nga palët nuk arrijnë të caktojnë një arbitër të tretë brenda tridhjetë (30) ditëve të emërimit të tyre nga secila palë, arbitri i tretë, me kërkesë të çdonjërës nga palët, do të caktohet nga sekretari i përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, Hagë; dhe

b) në qoftë se njëra nga palët nuk e cakton arbitrin e saj brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që pala tjetër ka caktuar arbitrin e saj, pala që ka caktuar arbitrin, mund të kërkojë nga sekretari i përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, Hagë të caktojë një arbitër të vetëm për çështjen që është objekt mosmarrëveshjeje, dhe arbitri i zgjedhur në këtë mënyrë do të jetë arbitri i vetëm për këtë mosmarrëveshje.

##### 10.2.2 Rregullat e procedurës

Me përjashtim të rastit kur kjo kontratë parashikon ndryshe, procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen në përputhje me rregullat për procedurat e arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin Tregtar Ndërkombëtar (UNCITRAL), që janë në fuqi në datën e kësaj kontrate.

##### 10.2.3 Zëvendësimi i arbitrave

Në qoftë se për ndonjë arsye, një arbitër nuk mund të përmbushë funksionin e tij, do të caktohet një zëvendësues në të njëjtën mënyrë me arbitrin e parë.

##### 10.2.4 Kombësia dhe kualifikimet e arbitrave

Arbitri i vetëm ose arbitri i tretë i caktuar sipas nenit 10.2.1 më sipër do të jetë një ekspert ligjor ose teknik i mirënjohur ndërkombëtar me eksperiencë të gjerë mbi objektin e mosmarrëveshjes dhe nuk do të ketë kombësinë e vendit të origjinës së Kontraktuesit ose atë shqiptare. Për qëllime të këtij neni, “vendi i origjinës” nënkupton secilin prej:

a) vendit të themelimit të Kontraktuesit; ose

b) vendin në të cilin ndodhet vendi kryesor i ushtrimit të aktivitetit të Kontraktuesit.

##### 10.2.5. Të ndryshme

Në çdo procedurë arbitrazhi sipas kësaj kontrate:

a) procedurat, përveçse kur palët bien dakord ndryshe, do të zhvillohen në Hagë;

b) gjuha angleze do të jetë gjuha zyrtare për të gjitha qëllimet; dhe

c) vendimi i arbitrit të vetëm ose shumicës së arbitrave (ose i arbitrit të tretë, nëse nuk është arritur shumica) do të jetë përfundimtar dhe detyrues dhe do të jetë i ekzekutueshëm në çdo gjykatë të juridiksionit kompetent. Palët heqin dorë në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar nga çdo imunitet që u takon ose mund t'u takojë në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë imunitetin nga juridiksioni, ekzekutimi, procedurat paragjyqësore, masa sigurimi dhe procedura të tjera ligjore dhe lehtësime, si në lidhje me veten, ashtu dhe me asetet e tyre, dhe miratimi për këto procedura dhe lehtësime.

Në dëshmi të sa më sipër, palët e mëposhtme nënshkruajnë këtë kontratë në datën dhe në vitin e përcaktuar më sipër.

Për Autoritetin Kontraktues:

[Emri]: \_\_\_\_\_

[Titulli]

Për Kontraktuesin:

[Emri]: \_\_\_\_\_

[Titulli]

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë